



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.986/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “D...” me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N.S. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë,të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1788/19, të datës 06.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1788/19, të datës 06.04.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, në paragrafin e parë të dispozitivit është vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit NTP “D...” me seli në Prizren, si e bazuar. Në paragrafin e dytë anulohet aktvendimi nr.07.3/1213:43:1296/2015-2016 i datës 03.07.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në paragrafin e tretë Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit NTP “D...” me seli në Prizren, t’ia kthej shumën prej 2,289.38 euro (dy mijë e dyqind e tetë dhjetë e nëntë euro e tri dhjetë e tetë cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore për shkak

të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr, R-33659/29.12.2015, R- 30272/25.11.2015, R- 31930/11/12.2015 të ZBD Prizren me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data paraqitjes së padisë në gjykatë me 26.07.2019 e deri në pagesën e plotë si dhe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtin për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa, të priset aktgjykimi A.nr.1788/19, të datës 06.04.2021, si të pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe të lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej Gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e kundërshtuar nr.07.3/1213:43:1296/2015-2016 I datës 03.07.2019, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit R- 33659/29.12.2015, R- 30272/25.11.2015, R- 31930/11/12.2015 të ZBD Prizren.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka

theksuar se paditësi i ka paraqit gjykatës provat materiale faturat e shpenzimeve të transportit, pagesat bankare të cilat përmbajnë edhe numrat e faturave të transportit. Gjykata ka vlerësuar se paditësi i'u ka drejtuar Sektorit për rishqyrtimin e vendimeve, qe te rishqyrtoj vendimin e zyrës doganore në Prizren, e që ankesës i'a ka bashkangjitë faturen, transanksionin bankar si dokumente përcjellëse që përcaktojnë vlerën e shpenzimeve te transportit, mirepo e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës nuk ka marr për bazë fare këto pretendime të paditësit për të vlerësuar se a janë paguar shpenzimet transportuesit të mallit.

Ka shtuar tutje se dispozita e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve Transportit të Mallrave të Importuara, ka paraparë elementet që duhet marrë parasysh gjatë shqyrtimit të Deklaratës unike doganore lidhur me paritetin, dhe në pikën 3.4 të kësaj dispozite janë cekur edhe dokumentet që kërkohen lidhur me paritetin e mallit si: kontrata, fatura, mënyra e pagesës dhe dëshmi tjera te cilat prova paditesit i ka paraqit me rastin e zhdoganimit te mallit lendor e te cilat gjenden ne shkresa te lendes. Nga arsyetimi i vendimit kontestues konstatohet se e paditura nuk ka bërë shqyrtimin e pagesave bankare të cilat dëshmojnë se është paguar vlera e shpenzimeve të transportit detar sipas faturave të deklaruara të transportit. E paditura nuk ka mbështetur konstatimet e veta me argumente se paditësi i ka paguar transportuesit vlera më të larta për shpenzimet e transportit se sa vlera e shpenzimeve të deklaruara, përderisa paditësi në procedurën e konfliktit administrativ i ka paraqit gjykatës dokumentacionet përcjellëse të mallit të lartcekura të cilat nuk janë shqyrtuar fare në procedurën administrative të ankesave.

Nga këto prova materiale gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se dokumentacioni përcjellës i shpenzimeve të transportit është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit dhe përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturave përcjellëse të shpenzimeve të transportit, pasi që nga transaksionet bankare që dëshmojnë vlerën reale të paguar për këto shpenzime, shpenzimet e transportit duhet të vlerësohen sipas vlerës së deklaruar të transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për shpenzimet e transportit.

Gjykata ka shqyrtuar bazën ligjore kur ka aplikuar e paditura ne vendimin kontestues përkatësisht nenin 3 te UA 04/2014, e cila dispozite rregullon çështjen e shpenzimeve transportit ne raste se

subjekti ne procedure nuk ka paraqitur prova për te dëshmuar vlerën e shpenzimeve te transportit, e jo si ne rastin konkret kur paditësi ka paraqitur te gjitha provat duke përfshirë faturën, transaksionon bankar duke cekur numrin për pagese e faturës se shpenzimeve te transportit e qe plotëson dispozitat ligjore te nenit 33 te KDA-se. Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore sa i përket vlerën se transaksionit për pagesën e faturës se mallit lëndor në kuptim të nenit 33 te KDA-së i cili nen thotë: *Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.* Ne interpretim te drejte te kësaj dispozite ligjore dhe provave te paraqitura nga paditësi rezulton fakti se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar për shpenzime e transportit i cili dëshmon çmimin realisht te paguar për shpenzimet e tilla, e ne këtë kuptim janë ne pajtim me dispozitat ligjore e lartëcekura.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, në seancën e mbajtur me datë 06.04.2021, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar

padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë që është e bazuar në ligj mbi bazën e të cilave e paditura e ka ngarkuar paditësin me pagesë shtesë në emër të taksave doganore importuese.

Në raport me pretendimet e të paditurës se se e paditura ka shlyrtuar gjithë dokumentacionin përcjellës të mallit dhe ka dhënë arsyet se si ka ardhur deri te ky konstatim Këtë pretendim Kolegji i Gjykatës Komerciale e refuzoj si të pa bazuar për faktin se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor ne pajtim me nenit 33 te Kodit Doganor dhe te Akcizave. Andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke u bazuar në interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore sa i përket dokumenteve që duhet ti bashkangjiten deklaratës doganore gjatë zhdoganimit të mallit, dhe nga kjo rezulton se paditësi ka paraqitur dokumentet e nevojshme për të vërtetuar pagesën e mallit lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar. Andaj edhe shkalla e dytë vlerëson se dokumentacioni përcjellës i shpenzimeve të transportit është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit dhe përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlere e deklaruar sipas faturave përcjellëse të shpenzimeve të transportit, pasi që nga transaksionet bankare që dëshmojnë vlerën reale të paguar për këto shpenzime, shpenzimet e transportit duhet të vlerësohen sipas vlerës së deklaruar të transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për shpenzimet e transportit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cënuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim

në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzuar si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
K.DH.SH.II.nr.986/22, me datë 18.05.2023

Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti